

Përmbledhje e Udhëtimeve të Mosia 7–24

- 1 Disa nefitë përpiqen të rizotërojnë tokën e Nefit.** Ata luftojnë me njëri-tjetrin dhe të mbijetuarit kthehen në Zarahemla. Zenifi është pjesë e këtij grupi. (Shih Omni 1:27–28; Mosia 9:1–2.)
- 2 Grupi nefit i udhëhequr nga Zenifi** vendoset mes lamanitëve në tokën e Nefit (shih Omni 1:29–30; Mosia 9:3–5).
Pasi Zenifi vdiq, i biri, Noeu, mbretëroi në ligësi. Abinadi i paralajmëroi njerëzit që të pendoheshin. Alma iu bind mesazhit të Abinadit dhe ia mësoi atë të tjerëve pranë Ujërave të Mormonit. (Shih Mosia 11–18.)
- 3 Alma dhe populli i tij largohen** nga mbreti Noe dhe udhëtojnë për në tokën e Helamit (shih Mosia 18:4–5, 32–35; 23:1–5, 19–20).
Lamanitët sulmojnë popullin e Noeut në tokën e Nefit. Biri i Noeut, Limhi, mbretëroi ndërsa populli jetonte nën robërinë e lamanitëve. (Shih Mosia 19–20.)

- 4 Përpjekje për të gjetur Zarahemlën:** Limhi dërgon një grup për të gjetur Zarahemlën dhe për të marrë ndihmë. Grupi zbulon gërmadhat e një kombi të shkatërruar dhe 24 fletët e arta. (Shih Mosia 8:7–9; 21:25–27.)
- 5 Grupi kërkimor i udhëhequr nga Amoni** udhëton nga Zarahemla për të gjetur pasardhësit e atyre që kishin shkuar në tokën e Nefit (shih Mosia 7:1–6; 21:22–24).
- 6 Populli i Limhit arratiset** nga robëria dhe udhëhiqen nga Amoni në kthimin për në Zarahemla (shih Mosia 22:10–13).
Lamanitët dërgojnë një ushtri për të ndjekur Limhin dhe popullin e tij. Pasi humbet në shkretëtirë, ushtria zbuloi Almën dhe popullin e tij në tokën e Helamit. Lamanitët i nënshtruan në robëri. (Shih Mosia 22–24.)
- 7 Populli i Almës arratiset** nga robëria dhe udhëton për në Zarahemla (shih Mosia 24:20–25).

Gërmadha të Kombit Jaredit në Tokën në Veri

